

Banorët e Ejkes (*As'habul-Ejkeh*) dhe populli i Shuajbit

Allahu ﷻ përmend rrëfimin për peygamberin Shuajb në suren esh-Shu'araa duke thënë:

“Banorët e Ejkes (Shkurre) përgënjeshtuan të Dërguarit. Kur Shuajbi u tha: ‘A nuk do të keni frikë (nga Zoti)!’ (esh-Shu'araa, 176-177)

El-Hafidh Ismail ibn Kethir përmendi këtë në vijim gjatë diskutimit të këtyre ajeteve:

“Këta njerëz, pra banorët e Ejkes, janë populli i qytetit Medjen sipas mendimit të saktë. Peygamberi i Allahut ﷻ Shuajb qe njëri prej tyre. Arsyeja e vetme përse ai nuk u quajt si ‘vëllai i tyre’ është se këtu ky popull po përshkruhet në kontekstin e adhurimit që i bënin Ejkes (Shkurre), që ishte një lloj druri – disa thonë një lloj i përdredhur i drurit, si shkurre apo kaçubë – që ata adhuronin.

Për këtë shkak, kur Allahu tha ‘Banorët e Ejkes përgënjeshtuan të Dërguarit’, Ai nuk tha: ‘Kur vëllai i tyre Shuajbi u tha ...’, por tha: ‘Kur Shuajbi u tha ...’, duke shkëputur kështu lidhjen e vëllazërisë mes Shuajbit dhe popullit të tij, edhe pse ai, në fakt, ishte i lidhur me ta nga ana e prejardhjes.

Sidoqoftë, disa njerëz nuk e kuptuan këtë hollësisë dhe, për pasojë, menduan se banorët e Ejkes nuk qenë populli i Medjenit. Këta njerëz supozuan se Allahu ﷻ dërgoi Shuajbin ﷺ te dy popuj të ndryshëm; disa madje thanë se Allahu ﷻ e dërgoi atë te tre popuj të ndryshëm. (Pastaj Ibn Kethir ofron disa shembuj të këtyre pohimeve, së bashku me zinxhirin e tyre të transmetimeve, por këto nuk do të përfshihen këtu.)

Mendimi i saktë është se banorët e Ejkes dhe populli i Medjenit janë populli i njëjtë, meqë përshkruhen në mënyrë të njëjtë secilën herë që përmenden. Kjo është arsyeja përse Allahu ﷻ nxiti dhe urdhëron banorët e Ejkes për të qenë të vërtetë në peshimin apo matjen e sasive në transaksionet e tyre të biznesit (shih esh-Shu'araa, 181) saktësisht si në rrëfimin e Medjenit. Pra, kjo tregon se ata qenë populli i njëjtë.” (*Tefsir Ibn Kethir* 6/159-160)

Shejh Abdul-Aziz er-Rraaxhah po ashtu foli për këtë çështje duke perifrastuar Ibn Kethirin:

“Allahu ﷻ tha:

‘Banorët e Ejkes (Shkurre) përgënjeshtuan të Dërguarit. Kur Shuajbi u tha: ‘A nuk do të keni frikë (nga Zoti)!’ (esh-Shu'araa, 176-177)

Në këtë rast, Allahu nuk tha ‘Kur vëllai i tyre Shuajbi u tha ...’ sepse këtu ata po cilësohen me adhurimin e Ejkes – një lloj druri – dhe po identifikohen me të. Kështu, kur ata identifikohen me adhurimin e një idhulli, Shuajbi nuk përshkruhet me marrëdhëniet e afërta që kishte me ta. Kjo është në kontrast me thënien e Allahut ﷻ:

‘Dhe te Medjeni dërguam vëllanë e tyre, Shuajbin.’ (el-A’raf, 106)

Kjo sepse Medjen është emri i fisit dhe po ashtu emri i qytetit. Në këtë rast, Allahu ﷻ po na thotë se Shuajbi është vëllai i tyre dhe qëllimi i domethënies së vëllazërisë këtu është afërsia familjare. Kjo është si në rastin kur Allahu tha për të Dërguarit Nuh ﷺ, Hud ﷺ, Saalih ﷺ, dhe Lut ﷺ:

‘Kur vëllai i tyre Nuh u tha ...’ (esh-Shu’araa, 106)

‘Kur vëllai i tyre Hud u tha ...’ (esh-Shu’araa, 124)

‘Kur vëllai i tyre Saalih u tha ...’ (esh-Shu’araa, 142)

‘Kur vëllai i tyre Lut u tha ...’ (esh-Shu’araa, 161)

Dhe vëllazëri këtu përdoret në kuptimin e prejardhjes.” (*Fewaa'id Tefsir min Kelaam el-Shejkh Abdul-Aziz er-Raaxhihi*, nr.4.)